



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 5107 Prot.

Tirane, me 5/10/2010

UDHËZIM

Nr. 15 datë 5.10.2010

PËR

“LIMITET MAKSIMALE TË MBETJEVE TË PRODUKTEVE MJEKSORE
VETERINARE NË PRODUKTET USHQIMORE ME ORIGJINË SHTAZORË ”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, nenit 76 të ligjit 9590 datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare” dhe V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit” i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Për qëllimet e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

(a) “mbetjet e produkteve mjeksore veterinarë”: janë të gjitha substancat farmakologjike faktive, nëse në parim aktive, produktet e degraduara dhe metabolitët e tyre të cilat mbeten në produktet ushqimore që origjinojnë nga kafshët në të cilën produkti mjeksor veterinar ka qënë përdorur;

(b) “limit maksimal i mbetjeve”: është përqëndrimi maksimal i mbetjeve që rezultojnë nga përdorimi i një produkti mjeksor veterinar (i shprehur në mg / kg ose mg / kg peshë në bazë të freskët), të cilat mund të pranohen si të lejueshme ose të njohur si të pranueshme në një ushqim. Bazohet në llojin dhe sasinë e mbetjeve që konsiderohen të jenë pa ndonjë rrezik toksikologjik për shëndetin e njeriut të shprehur në sasi të pranueshme të përditshme (SPP), ose në bazë të një SPP të përkohshme që përdoret si faktor shtesë sigurie. Ajo gjithashtu merr parasysh reziqet e tjera të lidhura me shëndetin publik si dhe aspekte të teknologjisë ushqimore. Kur vendoset një limit maksimal i

Adresa: Blvd. “Deshmoret e Kombit” Nr.2
E-mail: Kabineti@mbumk.gov.al
Internet: <http://www.mbumk.gov.al>

Tel: +355 4 2227924
Tel: +355 4 2227924

9. Ky udhëzim nuk ndalon zbatimin e legjislacionit për ndalimin e përdorimit në blegtori dhe bujqësi të substancave të caktuara që kanë një veprim hormonal.

10. Për zbatimin e këtij urdhëzmi ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi më menjehere.

MINISTRI



Adresa: Blvd. "Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabineti@mbumk.gov.al
Internet: <http://www.mbumk.gov.al>

Tel: +355 4 2227924
Tel: +355 4 2227924



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. Prot.

Tirane, me / / 2010

UDHËZIM

Nr. _____ datë _____

PËR

**“LIMITET MAKSIMALE TË MBETJEVE TË PRODUKTEVE MJEKSORE
VETERINARE NË PRODUKTET USHQIMORE ME ORIGJINË SHTAZORË ”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, nenit 76 të ligjit 9590 datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare” dhe V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit” i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

(a) “mbetjet e produkteve mjeksore veterinare”: janë të gjitha substancat farmakologjike faktive, nëse në parim aktive , produktet e degraduara dhe metabolitët e tyre të cilat mbeten në produktet ushqimore që origjinojnë nga kafshët në të cilën produkti mjeksor veterinar ka qënë përdorur ;

(b) “limit maksimal i mbetjeve”: është përqëndrimi maksimal i mbetjeve që rezultojnë nga përdorimi i një produkti mjeksor veterinar (i shprehur në mg / kg ose mg / kg peshë në bazë të freskët), të cilat mund të pranohen si të lejueshme ose të njohur si të pranueshme në një ushqim. Bazohet në llojin dhe sasinë e mbetjeve që konsiderohen të jenë pa ndonjë rrezik toksikologjik për shëndetin e njeriut të shprehur në sasi të pranueshme të përditshme (SPP), ose në bazë të një SPP të përkohshme që përdoret si faktor shtesë sigurie. Ajo gjithashtu merr parasysh rreziqet e tjera të lidhura me shëndetin publik si dhe aspekte të teknologjisë ushqimore. Kur vendoset një limit maksimal i

mbetjeve (LMM), janë marrë në konsideratë edhe mbetjet që ndodhen në ushqimet me origjinë nga bimët dhe / ose vijnë nga mjedisi.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për përbërsit aktive me origjinë biologjike që përdoren me qëllim që të prodhojnë imunitet aktive ose pasiv ose për të diagnostikuar gjendjen e imunitetit nga përdorimi i produkteve mjeksore veterinarë imunologjike.

3. Lista e substancave farmakologjike aktive të përdorura në produktet mjeksore veterinarë në lidhje me të cilat janë vendosur kufijtë maksimale të mbetjeve, është në Shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kur, pas një vlerësimi të substancave farmakologjike aktive të përdorur në produktet mjeksore veterinarë, tregon që për mbrojtjen e shëndetit publik nuk është e nevojshme të vendoset një kufi maksimal të kësaj mbetje, këto substanca përfshihen në listën e Shtojcës II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Lista e substancave farmakologjike aktive të përdorura në produktet mjeksore veterinarë në lidhje me të cilën janë vendosur limitet e perkohëshëm maksimale të mbetjeve, është në Shtojcën III, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Limitet maksimale të mbetjeve nuk mund të vendosen në lidhje me një substancë aktive farmakologjike të përdorur në produktet mjeksore veterinarë kur mbetjet të substancave në fjalë, në çfarëdo limiti, në ushqimet me origjinë shtazore përbëjnë një rrezik për shëndetin e konsumatorit. Lista e këtyre substancave është në Shtojcën IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Përdorimi i substancave të listuara në Shtojcën IV tek kafshët që prodhojnë ushqim është i ndaluar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. Nuk ndalohet vënia në treg të produkteve me origjinë shtazore, për arsye se ato përmbajnë mbeturina të produkteve mjeksore veterinarë në qoftë se sasia e mbetjeve nuk kalon limitin maksimal të mbetjeve të parashikuara në Shtojcën I dhe III, ose nëse substanca në fjalë është e listuar në Shtojcën II, të bashkëlidhura këtij udhëzimi.

8. Përdorimi në kafshët që prodhojnë ushqim, i produkteve mjeksore veterinarë që përmbajnë substanca farmakologjike aktive të cilat nuk janë përmendur në Shtojcat I, II dhe III janë të ndaluara brënda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç në rastin e testeve klinike, që nuk shkaktojnë në produktet ushqimore me origjinë nga kafshët duke marrë pjesë në të tilla teste rrezik për shëndetin e njeriut.

9. Ky udhëzim nuk ndalon zbatimin e legjislacionit për ndalimin e përdorimit në blegtori dhe bujqësi të substancave të caktuara që kanë një veprim hormonal.

10. Për zbatimin e këtij urdhëzmi ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi më menjehere.

MINISTRI

GENC RULI

Konceptoi: M. XHEPA
Drejtori : G. MOKA
D. Pergjithshem: B. AHMETAJ
D. Juridik : F. PIPERI
Sek . Pergjithshem: A.KUSHTI